

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
REPUBLIKA E ITALISË**

Në vitin dy mijë e tre, në datën nëntë të muajit tetor, në Varese, në studion time, në Via Finocchiaro Aprile n.5, në katin e parë, përpara meje, **Dr. Carlo GAUDENZI**, noter në Varese, i regjistruar në Kolegjin Noterial të Milanos, pa praninë e dëshmitarëve nga të cilët u hoq dorë pasi ranë dakort mes tyre dhe me mua në përputhje me ligjin, ishin të pranishëm zotërinjtë:

- **RICARDO CELESIA**, lindur ne Novara (NO) më 14 janar 1958, me banim në Borgo Ticino (NO), Via Stazione, n. 9, farmacist, Kodi fiskal CLS RCR 58A14 F952F, i cili deklaron se është i martuar me kushtet e ndarjes së pasurisë;

- **MASSIMO DAVERIO** lindur në Somma Lombardo në 6 nëntor 1957, me banim në Sesto Calende (VA) në Piazza C. Abba n.1, teknik, kodi fiskal: DVR MSM 57S06 I819M, i cili deklaron se është i martuar me kushtet e ndarjes së pasurisë;

- **LORENZO PERALDINI** lindur në Ternate (VA) më 9 maj 1958, me banim në Ternate (VA) në Via Giotto n. 1, agjent tregëtar, kodi fiskal: PRL LNZ 58E09 L115A, i cili deklaron se është i martuar me kushtet e ndarjes së pasurisë; shtetas italianë. Personat e lartpërmendur për identitetin e të cilëve unë noter i jam i sigurtë, me anën e këtij akti bien dakort dhe hartojnë sa më poshtë vijon:

a) Krijohet ndërmjetë zotërinjve **RICCARDO CELESIA**, **MASSIMO DAVERIO** dhe **LORENZO PERALDINI**, me të dhënat e lartpërmendura, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur: "MEDICAMENTA GROUP SHPK".

b) Shoqëria ka si objekt:

- tregëtinë, sipas të gjitha normave ligjore, dhe me autorizimet e kërkuara nga ligji, të barnave, prodhimeve sanitare dhe parasanitare në përgjithësi, ortopedike në përgjithësi, artikuj të higjienës personale, të parfumerisë dhe kozmetikës;
- tregëtinë me shumicë dhe pakicë dhe dhënie me qera të makinerive, pajisjeve, pjesëve përkatëse të këmbimit dhe materialeve të konsumit që i përkasin sektorit të shëndetësisë;
- përfaqësinë tregëtare lidhur me të mirat dhe produktet e lartpërmendura;
- ngritjen dhe administrimin (e nënkuptuar edhe si organizim të mjeteve dhe personelit të nevojshëm për drejtimin logjistik dhe administrativ) të

strukturave sanitare dhe parasanitare, instituteve të bukurisë, qendrave estetike; dhe gjithçka tjetër të parashikuar nga neni përkatës i Statutit të Shoqërisë bashkëlidhur.

c) Shoqëria e ka selinë ligjore në Varese (VA), Via Cavour, n. 25. Ajo mund të krijojë si në Itali ashtu edhe jashtë saj seli dytësore (vetëm me vendim të asamblesë në përputhje me ligjin) dhe filiale, përfaqësi dhe agjensi dhe t'i mbyllë ato, në përputhje me dispozitat ligjore.

d) Kapitali i shoqërisë është përcaktuar 39.000 (tridhjetë e nëntë mijë) Euro dhe është i ndarë në kuota sipas nenit 2474 të Kodit Civil.

Ky kapital pranohet dhe nënshkruhet nga ortakët në masat e mëposhtme:

- nga ortaku Z. RICCARDO CELESIA me një kuotë prej 13.260 (trembëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) Euro ose 34% (tridhjetë e katër përqind) e kapitalit të shoqërisë;
- nga ortaku Z. MASSIMO DAVERIO me një kuotë prej 12.870 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) Euro ose 33% (tridhjetë e tre përqind) e kapitalit të shoqërisë;
- nga ortaku Z. LORENZO PERALDINI me një kuotë prej 12.870 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) Euro ose 33% (tridhjetë e tre përqind) e kapitalit të shoqërisë.

Të pranishmit pohojnë se, nga kuotat e kapitalit të shoqërisë të pranuar dhe të nënshkuara respektivisht nga secili prej tyre, janë derdhur në datën 6 tetor 2003 pranë Institutit: BANCA CARIGE, dega Gallarate, tre të dhjetat, sipas Neneve 2475 dhe 2329 të Kodit Civil, siç rezulton edhe nga fatura e depozitimit për shumën 11.700 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) Euro lëshuar në datën 6 tetor 2003 nga Instituti i lartpërmendur, një kopje e së cilës e vlerësuar e rregullt nga unë noteri në datën e sotme me numër regjistri 72.801, i bashkëlidhet këtij akti nën gërmën "A". Organi Administrativ do të kërkojë pjesën e mbetur në afatet dhe mënyrat e përcaktuara nga ligji.

f) Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar nga sot deri më 31 dhjetor 2050 (dy mijë e pesëdhjetë) dhe mund të shkrihet përpara këtij afati ose mund të shtyhet më tej me vendim të asamblesë.

IRANE

g) Periudha e parë e aktivitetit të shoqërisë do të mbyllet në 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2003 (dy mijë e tre).

h) Shoqëria deklarohet e krijuar në përputhje të plotë me normat që përmban ky akt dhe me ato që përcaktohen në Statutin e Shoqërisë, që pas leximit nga ana ime për të pranishmit, miratohet prej tyre dhe i bashkëlidhet këtij akti nën gërmen "B".

Për gjithçka që nuk është parashikuar, palët i referohen shprehimisht normave të Statutit bashkëlidhur si edhe normave të ligjit mbi shoqëritë me kapitale të përbashkëta në përgjithësi dhe me përgjegjësi të kufizuar në veçanti.

i) Administrimi i shoqërisë i besohet një Këshilli Administrativ të përbërë nga 3 (tre) anëtarë, që do të rrinë në këtë funksion me kohë të papërcaktuar pra deri në dorëheqjen apo shkarkimin nga ana e Asamblesë, të cilëve u jepen kompetencat më të gjera për administrimin e zakonshëm të shoqërisë dhe kompetenca për të ndërmarrë, pa asnjë përjashtim, të gjitha aktet që vlerësohen në të mirë të realizimit të synimit të shoqërisë, me përjashtim vetëm të atyre që ligji dhe Statuti i rezervojnë në mënyrë taksative për Asamblenë. Presidentit - i cili do emërohet brenda Këshillit - i takon përfaqësimi ligjor i shoqërisë me të tretët dhe në gjykatë. Organi administrativ gjithashtu rregullohet nga Statuti bashkëlidhur. Me vendim unanimit caktohen fillimisht si anëtarë të Këshillit Administrativ zotërinjtë e pranishëm: RICCARDO CELESIA, MASSIMO DAVERIO dhe LORENZO PREALDINI.

Personat e lartpërmendur e pranojnë detyrën dhe emërojnë President të Këshillit Administrativ Z. RICCARDO CELESIA, i cili e pranon detyrën.

1) Të pranishmit deklarojnë se autorizojnë dhe delegojnë Z. RICCARDO CELESIA, me të dhënat e lartpërmendura t'i bëjë këtij Akti dhe Statutit bashkëlidhur të gjitha ndryshimet dhe shtesat e mundshme të kërkuara nga Autoritetet kompetente për funksionimin ligjor të shoqërisë.

Të pranishmit deklarojnë se autorizojnë Z. RICCARDO CELESIA, me të dhënat e lartpërmendura, të tërheqë pranë Institutit të lartpërmendur: BANCA CARIGE, dega Gallarate, dhe/ose nga çdo degë apo filial tjetër i Institutit të lartpërmendur tre të dhjetat e kapitalit të shoqërisë që është derdhur, duke e shkarkuar zyrën

paqese dhe funksionarët e saj nga çdo përgjigjësi lidhur me këtë.

m) Të pranishmit pranojnë që duke patur parasysht kapitalin aktual të shoqërisë prej 39.000 (tridhjetë e nëntë mijë) Euro të mos caktohet Këshilli Sindikal, duke rezervuar megjithatë të drejtën që ta krijojnë atë më vonë në rast se kërkohet nga kushtet ligjore.

n) Shpenzimet e këtij akti dhe të Statutit të shoqërisë të bashkëlidhura apo të varura prej tij i ngarkohen shoqërisë dhe arrijnë shifrën jo më pak se 2.000 (dy mijë) Euro.

Në përputhje me ligjin nr. 151, datë 19 maj 1975, Z. RICCARDO CELESIA dhe Z. MASSIMO DAVERIO deklarojnë se janë në kushtet e ndarjes së pasurisë.

Të pranishmit bien dakort t'i ngarkojnë administratorëve (domethënë anëtarëve të Këshillit Administrativ) në përputhje me sa parashikohet nga neni 15 i statutit të shoqërisë, një dëshmpërblim prej 10% (dhjetë përqind) të shpërblimit të tyre vjetor.

Të pranishmit zotërinjtë RICCARDO CELESIA, MASSIMO DAVERIO dhe LORENZO PERALDINI, si anëtarë të Këshillit Administrativ, vendosin të caktojnë Këshilltar të Deleguar të shoqërisë Presidentin, Z. RICCARDO CELESIA, për të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.

Me kërkesën time, unë Noteri, mora këtë akt të shkruar pjesërisht në makinë nga një person që gëzon besimin tim dhe pjesërisht me dorë nga unë Noteri, dhe lexuar nga unë vetë, bashkë me lidhjen "B", të pranishmëve që e miratuan, duke më kërkuar të mos lexoj lidhjen "A".

Përmban dy fletë, shtatë seksione deri këtu.

RICCARDO CELESIA - nënshkrimi
MASSIMO DAVERIO - nënshkrimi
LORENZO PERALDINI - nënshkrimi
CARLO GAUDENZI NOTER - nënshkrimi



LIDHJA "B" ME NUMËR REGJISTRI 72.802/10.020
NOTERI CARLO GAUDENZI
STATUTI I SHOQËRISË

Neni 1) Krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur: "MEDICAMENTA GROUP SHPK".

Neni 2) Shoqëria ka si objekt:

- tregëtinë, sipas të gjitha normave ligjore, dhe me autorizimet e kërkuara nga ligji, të barnave, prodhimeve sanitare dhe parasanitare në përgjithësi, ortopedike në përgjithësi, artikuj të higjienës personale, të parfumerisë dhe kozmetikës;
- tregëtinë me shumicë dhe pakicë dhe dhënie me qera të makinerive, pajisjeve, pjesëve përkatëse të këmbimit dhe materialeve të konsumit që i përkasin sektorit të shëndetësisë;
- përfaqësinë tregëtare lidhur me të mirat dhe produktet e lartpërmendura;
- ngritjen dhe administrimin (e nënkuptuar edhe si organizim të mjeteve dhe personelit të nevojshëm për drejtimin logjistik dhe administrativ) të strukturave sanitare dhe parasanitare, instituteve të bukurisë, qendrave estetike.

Të gjitha këto në përputhje me normat ligjore që disiplinojnë dhe rregullojnë aktivitetet e ashtuquajtura "të mbrojtura", në kuptimin që për zhvillimin e këtyre aktiviteteve shoqëria do të shfrytëzojë për rastet specifike vetëm profesionistë ad hoc, të regjistruar në regjistrat profesionale përkatës.

Ajo do mund të kryejë çfarëdo veprimi me pasurinë e tundshme e të patundshme, industriale, tregëtare (përfshi këtu marrjen e mandateve, përfaqësimet, agjensitë, lëshimin e garancive dhe në përgjithësi çfarëdo garancie reale dhe personale, edhe në favor të të tretëve), si edhe financiare (por gjithnjë duke synuar realizimin e objektit të shoqërisë dhe jo drejtuar publikut dhe as me mbledhje kursimesh), që do të cilësohen nga organi përkatës administrativ si të nevojshme ose të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë; mund të ndërmarrë gjithashtu bashkëveprime dhe pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo gjithsesi të lidhur me të vetin dhe jo me qëllim shkrirjeje me to apo ndryshim të objektit të shoqërisë.



Neni 3) Shoqëria e ka selinë në Varese (VA), Via Cavour, n. 25. Ajo mund të krijojë si në Itali ashtu edhe jashtë saj seli dytësore (vetëm me vendim të asamblesë në përputhje me ligjin) dhe filiale, përfaqësi dhe agjensi dhe t'i mbyllë ato, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 4) Vendbanimi i ortakëve, për sa ka lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, është ai i deklaruar në aktin e themelimit ose në çastin e marrjes së cilësisë së ortakut ose që i komunikohet me shkrim shoqërisë më vonë.

Neni 5) Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri më 31 dhjetor 2050 (dy mijë e pesëdhjetë) dhe mund të shkrihet përpara këtij afati ose mund të shtyhet më tej me vendim të asamblesë.

Neni 6) Kapitali i shoqërisë është i përcaktuar në 39.000 (tridhjetë e nëntë mijë) Euro. Kuotat e ortakëve mund të jenë të shumave të ndryshme, por në asnjë rast më të vogla se një Euro. Nëse kuota është më e madhe se minimalja, ajo duhet të përbëjë një shumëfish të një Euroje.

Neni 7) Kuotat e shoqërisë mund të transferohen lirisht me marrëveshje të çfarëdo lloji mes personave, në rastin kur ato i kalojnë ortakëve të tjerë ose bashkëshortit apo pasardhësve të drejtpërdrejtë të ortakëve.

Përveç rasteve të lartpërmendura, për kalimin e kuotave të shoqërisë personave të tretë jashtë shoqërisë, në çdo rast ortakëve u rezervohet e drejta e preferencës.

Prandaj ortaku që do t'i shesë personave të tretë jashtë shoqërisë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e veta, duhet t'i vërë në dispozicion të Administratorit të Vetëm ose Këshillit Administrativ nëpërmjet një letre rekomande me njoftim mbërritjeje. Brenda dhjetë ditësh nga marrja e letrës së lartpërmendur Administratori i Vetëm ose Këshilli Administrativ ua ofron kuotat që janë në shitje të gjithë ortakëve të tjerë, me anën e një njoftimi me letër rekomande me njoftim mbërritjeje dërguar të gjithë ortakëve, në vendbanimin e secilit prej tyre siç figuron nga libri i ortakëve. Në këtë njoftim duhet të saktësohet cmimi dhe kushtet e blerjes.

E drejta e preferencës duhet të ushtrohet nga ortakët, brenda kohës së caktuar, me anën e një letre rekomande me njoftim mbërritjeje dërguar Administratorit të Vetëm ose Këshillit Administrativ brenda gjashtëdhjetë ditësh nga data e marrjes së njoftimit. Kuotat e blera ndahen ndërmjet ortakëve blerës në përpjestim me ato që ata zotërojnë.

Nëse ndonjë nga ortakët nuk ushtron të drejtën e preferencës, kuotat që i takojnë atij do të ndahen mes ortakëve që e kanë ushtruar atë, në të njëjtin përpjestim si më lart.



Kuotat që në fund kanë mbetur të pablera mund të shiten lirisht nga ortaku.

Në çdo rast kur, për ushtrimin e të drejtës së preferencës, lindin mosmarrëveshje lidhur me çmimin e shitjes së kuotave, ai mund të caktohet mbi bazën e gjendjes së pasurisë së shoqërisë në datën e shitjes, nga një arbitër i vetëm i zgjedhur për këtë qëllim me kërkesë qoftë edhe të njërës prej palëve, nga Kryetari i Gjykatës së Varezës.

Neni 8) Asambletë janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme në përputhje me ligjin. Asambleja e zakonshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit, brenda katër muajve nga mbyllja e aktivitetit vjetor. Ky afat mund të shtyhet në gjyshtë muaj kur kërkohet për shkak të kushteve të veçanta. Asambleja e jashtëzakonshme mbledhet sa herë që administrata e vlerëson të arsyeshme dhe në çdo rast që parashikohet nga statuti apo nga ligji.

Neni 9) Asambleja duhet të mbledhet pas një letre rekomande dërguar ortakëve të paktën tetë ditë përpara datës së caktuar për mbledhje, në vendbanimin që figuron në librin e ortakëve. Në letër duhet të tregohen dita, vendi, ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve që do trajtohen. Në mungesë të formaliteteve të lartpërmendura asambleja quhet e mbledhur rregullisht kur përfaqësohet i gjithë kapitali i shoqërsisë dhe në të merr pjesë Administratori i Vetëm ose i gjithë Këshilli Administrativ dhe të gjithë pjesëtarët e Kolegjit Sindikal, nëse është formuar. Në këtë rast secili nga pjesëmarrësit mund të kundërshtojë diskutimin e çështjeve për të cilat mendon se nuk është informuar aq sa duhet.

Në asamble mund të marrin pjesë të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar në librin e ortakëve prej të paktën 8 (tetë) ditësh përpara asamblesë dhe që kanë plotësuar kërkesat e ligjit.

Neni 10) Çdo ortak ka të drejtën e një vote për çdo Euro që përfshihet në kuotën e tij.

Neni 11) Asambletë mund të mbledhen edhe jashtë selisë së shoqërisë, por vetëm në Itali.

Neni 12) Asambleja drejtohet nga Administratori i Vetëm ose nga Presidenti i Këshillit Administrativ.

Në rast të mungesës apo pamundësisë së tyre për të marrë pjesë asambleja zgjedh Presidentin e saj.

Presidenti i Asamblesë cakton një sekretar, qoftë edhe jo ortak, dhe, nëse e sheh të arsyeshme, edhe dy vëzhgues. Caktimi sekretarit nuk është i nevojshëm kur procesverbalin e asamblesë e mban noteri.

Neni 13) Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet me anën e një akti të shkruar,



në përputhje me masat e përcaktuara nga neni 2372 i Kodit Civil.

Neni 14) Vendimet e asamblesë, qoftë e zakonshme apo e jashtëzakonshme, duhet të merren me shumicën e parashikuar nga ligji dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë ortakët, edhe për ata që mungojnë apo për ata që janë kundër.

Vendimet e asamblesë shënohen në procesverbalin përkatës të nënshkruar nga Presidenti dhe nga Sekretari, që ka fuqi në përputhje me ligjin.

Neni 15) Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm apo nga një Këshill Administrativ i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë ose nga një Administrator i Vetëm, të zgjedhur, edhe ndërmjet atyre që s'janë ortakë, fillimisht në aktin e themelimit dhe më pas nga asambleja e zakonshme për periudhën që vetë asambleja do ta përcaktojë çdo herë në aktin e emërimit. Numri i administratorëve përcaktohet nga asambleja në aktin e emërimit të tyre.

Nëse Këshilli Administrativ është i përbërë nga dy anëtarë, kur ka mosmarrëveshje lidhur me shkarkimin e një këshilltari të deleguar, konsiderohet i shpërndarë i gjithë këshilli.


Administratorët duhet të kthejnë shpenzimet e bëra për përmbushjen e detyrës së tyre.

Veç kësaj asambleja mund të caktojë për administratorët një shpërblim vjetor dhe t'u ngarkojë atyre një dëmshpërblim për fundin e mandatit në masën që e sheh të arsyeshme.

Neni 16) Administratorit të Vetëm dhe Këshillit Administrativ i jepet pushtet i plotë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa përjashtime, me mundësinë për të kryer të gjitha veprimet që do të vlerësojnë të arsyeshme për arritjen dhe realizimin e synimeve të shoqërisë, përjashtojë vetëm ato që ligji dhe statuti i rezervon në mënyrë taksative për asamblenë e ortakëve.

Neni 17) Kur shoqëria administrohet nga një Këshill Administrativ:

- a) Këshilli zgjedh mes anëtarëve të tij një President dhe mund të zgjedhë edhe një Zv/President dhe të caktojë një sekretar që mund edhe të mos jetë anëtar i Këshillit;
- b) Nëse, për shkak të dorëheqjes apo për arsye të tjera, mungon shumica e Administratorëve, konsiderohet i shpërndarë i gjithë Këshilli dhe duhet mbledhur urgjentisht asambleja për emërimet e reja; në periudhën kalimtare deri në emërimin e Këshillit të



ri, këshilli mund të ndërmarrë vetëm veprime të administrimit të zakonshëm;

- c) Këshilli mblihdet, edhe në një vend të ndryshëm nga selia e shoqërsisë, sa herë që Presidenti e gjykon të nevojshme dhe kur për këtë bëhet kërkesë me shkrim nga të paktën dy anëtarë të tij;
- d) Thirrja e Këshillit bëhet nga Presidenti, me letër që i dërgohet secilit nga anëtarët e tij të paktën tre ditë përpara dhe, në rast urgjence, me telegram ose faks dërguar të paktën një ditë përpara secilit prej anëtarëve të Këshillit Administrativ; vendimet e Këshillit janë të vlefshme nëse arrihet prania efektive e shumicës së anëtarëve të tij dhe vota pro e shumicës absolute të të pranishmëve.

Neni 18) Pranohet mundësia që pjesëmarrësit në mbledhjen e Këshillit Administrativ të ndërhyjnë në distancë, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të ndërlidhjes audiovizive. Në këtë rast duhet të sigurohen:

- a) identifikimi të gjithë pjesëmarrësve në cilëndo fazë të lidhjes;
- b) mundësia për secilin prej anëtarëve të ndërhyjnë, të shprehin me fjalë mendimin e tyre, të shohin, të marrin apo të përcjellin të gjithë dokumentacionin, si edhe kontekstin e shqyrtimit dhe të vendimit.

Në rast ndërhyrjeje të pjesëmarrësve nga distanca mbledhja e Këshillit Administrativ do të konsiderohet e mbajtur në vendin ku duhet të ndodhen në të njëjtën kohë Presidenti dhe Sekretari.

Neni 19) Si Administratori i Vetëm ashtu edhe Këshilli Administrativ do kenë kompetencën të caktojnë drejtorë dhe përfaqësues ligjorë të posaçëm për veprime apo kategori veprimesh të posaçme.

Këshilli Administrativ mund t'i delegojë, plotësisht apo pjesërisht, kompetencat e tij njërit apo disa Administratorëve të Deleguar.

Neni 20) Administratori i Vetëm ose Presidenti i Këshillit Administrativ, kur shoqëria administrohet nga një këshill, ose Administratorët e Deleguar, përfaqësojnë ligjërisht shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe në gjykatë, dhe kanë kompetencën të ndërmarrin veprime dhe procese gjyqësore dhe administrative, në çdo shkallë juridiksioni edhe për gjykimet e anulimit dhe kasacionit duke emëruar sipas nevojës avokatë apo akuzues në debate.

Neni 21) Në përputhje me detyrimin që përcakton ligji do ngrihet një Kolegj Sindikal, i përbërë nga tre anëtarë efektivë dhe dy zëvendësues, të emëruar dhe në funksionet e



përcaktuara nga ligji. Shpërblimi për anëtarët do të përcaktohet në bazë të tarifave profesionale.

Neni 22) Aktiviteti vjetor mbyllet në 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Neni 23) Bilanci hartohet sipas dispozitave ligjore, nga organi administrativ në mbyllje të çdo aktiviteti vjetor. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci i shoqërisë i miratuar rregullisht, nga ku zbritet një shumë jo më pak se 5 % (pesë përqind) për fondin e rezervës ligjore, ndahen ndërmjet ortakëve, në përpjestim të drejtë me kuotat përkatëse, përveç rastit kur asambleja vendos ndryshe.

Pagimi i pjesëve të fitimit bëhet në Arkën e caktuar nga Organi Administrativ dhe brenda afatit që caktohet çdo vit nga vetë Organi Administrativ. Pjesët e patërhequra brenda pesë vjetësh nga dita kur fillon mundësia për t'i tërhequr kalojnë në favor të shoqërisë.

Neni 24) Në rast se arrihet, në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, në prishjen e shoqërisë, rregullat për likuidimin dhe për emërimin e likuidatorit apo likuidatorëve përcaktohen nga asambleja në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 25) Ortakët që janë të tillë të paktën prej tre muajsh dhe që zotërojnë një pjesë të kapitalit jo më të vogël se 2% (dy përqind), sipas bilancit të fundit të miratuar, mund të bëjnë financime për shoqërinë, me detyrimin për shlyerje në përputhje me nenin 11 të Dekretit Legjislativ nr. 385, datë 1 shtator 1993, Teksti i Vetëm i ligjeve mbi çështjet bankare dhe të kredive, me vendimin e Komitetit Ndërmënyësor për Kreditin dhe Kursimet i datës 3 mars 1994 dhe me çdo dispozitë të mëvonëshme që rregullon çështjet në fjalë.

Ortakët mundën gjithashtu të bëjnë derdhje të shumave në llogarinë e kapitalit në përpjestim me kuotat që zotërojnë që do të jenë të kthyeshme në përputhje me mundësitë e shoqërisë.

Këto financime dhe derdhje shumash, përveç rastit kur vendoset shprehimisht kundër, janë jofitimprurëse dhe si rrjedhim nuk mund të zbatohet në asnjë rast dispozita fiskale sipas neneve 42 dhe 43 të Dekretit të Presidentit të Republikës të datës 22 dhjetor 1986.

Kjo marrëveshje është e pakthyeshme dhe e detyrueshme për vetë ortakët dhe pasuesit e tyre.

Neni 26) Për gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht nga ky statut, zbatohen dispozitat në fuqi të Kodit Civil dhe të ligjeve të tjera që rregullojnë këtë çështje.

NOTER
TINAF

RICCARDO CELESIA - nënshkrimi
MASSIMO DAVERIO - nënshkrimi
LORENZO PERALDINI - nënshkrimi
CARLO GAUDENZI NOTER - nënshkrimi

Kjo kopje e realizuar në mënyrë elektronike, e përbërë prej 12 (dymbëdhjetë) seksionesh, është e njëjtë me origjinalin dhe lëshohet për t'u përdorur në përputhje me ligjin. Varese, më shtatëmbëdhjetë tetor dy mijë e tre.

